1678

Gmail

Res Publica <qendra.respublica@gmail.com>

76/1

Kerkese per informacion Nr. Prot 76/20

Etleva Shore <Etleva.Shore@infrastruktura.gov.al> Fri, Jul 24, 2020 at 1:43 PM
To: "qendra.respublica@gmail.com" <qendra.respublica@gmail.com>
Cc: Viola Haxhiademi <Viola.Haxhiademi@infrastruktura.gov.al>

Pershendetje,

Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion derguar me email-in me poshte me lejoni tju bejme me dije si vijon:

- *A ka filluar funksionin e saj hekurudha për linjën Fier-Vlorë?*

  Hekurudha Fier – Vlore funksionon per transport mallrash per momentin vetem per operatorin qe e ka me koncension ndersa per transport udhetaresh nuk funksionon.

  Per operatoret e tjere nuk funksionon per shkak te nderprerjes se kalimit hekurudhor ne Uren e Rrogozhines, e cila eshte e bllokuar nga ana e ARRSH-se sepse eshte e demtuar.

- *Nëse jo, cilat janë pengesat për mosrifillimin e funksionit të saj dhe kur është parashikuar fuksionimi?*

  Pengese eshte demtimi dhe bllokimi i kalimit ne Uren e Rrogozhines. Funksionimi do filloje pas riparimit te ures.

- *A është përllogaritur kostoja që shkaktohet për mosfuksioninim e kësaj hekurudhe? Nëse po, sa është kostoja?*

  Linja hekurudhore eshte rikonstruktuar dhe e gatshme per shfrytezim. Transporti i udhetareve eshte gjithmone me humbje per transportuesin ndaj dhe subvencionohet nga shteti kudo ndersa transporti i mallrave vazhdon nga operatori privat i koncensionit.

- *Hekurudha për linjën Fier-Vlorë është elektrike apo me motor me djegie të brendshme?*

  Gjithe linja hekurudhore ne Shqiperi eshte me motor me djegie të brendshme.

- *Sa është shpejtësia e saj?*

  Shpejtesia e projektuar e rikonstruksionit dhe e shfrytezimit eshte me 60 km/ore.